



ECO + C2E

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
Bardhë, Gri	Thes 25 kg	3-5 kg/m ²



PËRSHKRIM

Ngjitës për pllaka me bazë çimento me forcë ngjitëse të përmirësuar dhe kohë punueshmërie të gjatë. I përbërë nga rëra karbonesh të cilësisë së lartë dhe aditivë specifike. Karakterizohet nga një punueshmëri e shkëlqyer, rezistencë shumë e mirë ndaj lagështisë dhe ndaj ngriçave. I klasifikuar si ngjitës C2E sipas standartit EN 12004.

Aplikohet për shtresa deri në trashësi deri në 6mm.

FUSHA E APLIKIMIT

I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të qeramikës, në suporte me bazë çimento, qeramikës, gres-porcelanit, të pllakave me absorbim të ulët, etj. Për ngjitjen në bazamente me një lëvizshmëri të caktuar të tilla si ballkone, tarraca, banjo, për dysheme dhe mure në ambiente të jashme dhe të brëndshme ku ka prani lagështie. Për dysheme me trafik të lartë si shkolla dhe spitale I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave me dimensione mesatare dhe të mëdha (5-80 cm).



MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Përzierja 6.5-7 litra ujë të pastër me 25 kg ECO+, përziejeni masën e krijuar me një përzierës elektrik derisa të formohet një masë homogjene edhe pa kokrriza. Lëreni në qetësi për 10 minuta dhe më pas përziejeni përsëri përpara përdorimit. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë. Në kushte normale temperaturash (20°C)



PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vajra dhe jo të pista dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Përafërsisht, dyshemetë tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale, duhet të kenë një kohë stazhionimi të paktën 28 ditë, bazamentet me suva tradicionale duhet te thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhet të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike.



APLIKIMI

Fillimisht produkti rekomandohet të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës për të pasur një shpërndarje sa më të njëtrajtshme dhe më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Aplikimi bëhet me një mallë të përshtatshme në varësi të llojit të pllakës që shtrohet. Vendosja e pllakave bëhet duke ushtruar një presion të vogël mbi pllakë duke u siguruar që pllaka të mbulohet në të gjithë sipërfaqen me kollë. Koha e hapjes së produktit në kushte atmosferike normale është 35 minuta për temperatura 23 gradë C. Kushtet atmosferike mund të ndikojnë në kohën e tharjes së produktit. Duhet pasur kujdes që kolla nuk duhet të krijojë sipërfaqe filmi. Në të kundërt, është e nevojshme që të kalohet dhe një herë malla mbi kollë. Në sipërfaqet e bashkimit me muret vertikale duhet lënë një distancë prej 5mm.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thes letre 25 kg mbi paleta 1350 kg
Ngjyra:	Bardhë, Gri
Konsumi:	3-5 kg/m ²
Magazinimi:	Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Koha e magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit
Masa vëllimore:	1.6-1.7 gr/cm ³
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa A1
Ujë për përzierje:	6.5-7 litra ujë për 25 kg
pH i përzierjes:	13
Temperatura e aplikimit:	+5°C deri në +35°C
Koha e korigjimit:	35 min
Mbushja e fugave në mure:	Pas 8 deri 12 orësh
Mbushja e fugave në dysheme:	Pas 24 orësh
I shkëlshëm:	Pas 24 orësh
Forca ngjitëse pas 28 ditësh:	≥ 1 N/mm ²
Forca ngjitëse pas zhytjes në ujë:	≥ 1 N/mm ²
Forca ngjitëse në nxehtësi:	≥ 1 N/mm ²
Forca ngjitëse pas cikleve ngrirje-shkrirje:	≥ 1 N/mm ²
Forca ngjitëse pas 30 min:	≥ 0.5 N/mm ²
Rrëshkitshmëria:	≤ 0.5 mm